



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5359 prot

Roskovec , më 25.05 .2022

VENDIM

NR 34 .DATË 24.05 .2022

***“PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN NR.103 , DATË 24.12.2021  
“PËR MIRATIMIN E BUXHETIT, DHE NUMRIT MAKSIMAL TË PUNONJËSVE TË  
BASHKISË DHE NDËRMARJET VARTËSE TË BASHKISË ROSKOVEC, PËR VITIN  
2022”***

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore“, I ndryshuar, neni 54 gërma (dh), Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetore në RSH”; Udhëzimi nr.2 datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Vendimit Nr. 103 datë 24.12.2021 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratimin e buxhetit dhe numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe Ndërmarrjet Vartëse të Bashkisë Roskovec për vitin 2022”, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

1. Miratimin e një ndryshimi në vendimin e Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 103 datë 24.12.2021 “Për miratimin e buxhetit dhe numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe Ndërmarrjet Vartëse të Bashkisë Roskovec për vitin 2022”, si më poshtë vijon:
  - Numri maksimal i punonjësve për Bashkinë Roskovec dhe Ndërmarrjet Vartëse nga 341 bëhet 344 punonjës, 343 punonjës të përhershëm dhe 1 punonjës i përkohshëm, nga të cilët:
    - Njësia shpenzuese Bashkia Roskovec 183 punonjës të përhershëm;
    - Njësia shpenzuese “ Ndërmarrja e Pastrim, Gjelbërim dhe Mirmbajtje Varreza” nga 80 punonjës bëhet 81 punonjës, 80 punonjës të përhershëm dhe 1 punonjës i përkohshëm;
    - Njësia shpenzuese “ Ndërmarrja e Shërbimeve të Mirmbajtjes” nga 74 punonjës të përhershëm bëhet 76 punonjës të përhershëm;
    - Gjëndja Civile 4 punonjës së përhershëm.

Konkretisht shtohen në organiken e:

Ndërmarrjes së Pastrim, Gjelbërim dhe Mirmbajtjes së Varrezave 1 (një) punonjës i përkohshëm;

Ndërmarrjes së Shërbimeve të Mirmbajtjes 2 (dy) punonjës të përhershëm.

2. Fondi të perballohet nga fondi për pagat dhe sigurimet shoqerore të miratuar për vitin 2022.
3. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njërëzore dhe Çështjeve Juridike, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtuesit e institucioneve në varësi të Bashkisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**Kadri Hyska**

